



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. 180 të vitit 2024, me të pandehur **Anila Dusha**, e akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, e parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Bib Ndreca, Erjon Bani dhe Elsa Ulliri, me vendimin Nr. **74**, datë **10.12.2024** vendosi:

1. Deklarimin fajtores të të pandehurës **Anila Dusha**, për kryerjen e veprës penale të “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve, dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*” parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, dhe dënimin e saj me 3(tre) vjet burgim.
2. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i ulet 1/3 e dënimit duke u dënuar e pandehura përfundimisht me 2 (dy) vite burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i K.Penal.
3. Bazuar në nenin 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të mëtejshëm të vendimit me burgim për të pandehurën **Anila Dusha**, duke u detyruar që të mbajë kontakte me zyrën vendore të Shërbimit të Provës Tiranë. Vënia në provë e të pandehurës për një periudhë kohe prej 4 (katër) vitesh, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.
4. Në zbatim të nenit 61 të Kodit Penal, detyrohet e pandehura që gjatë kohës së provës: a).T’i përgjigjet thirrjeve dhe kërkesave të Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë; b).Të marrë pëlqimin në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë për ndryshimin e vendbanimit.
5. Në bazë të nenit 389 të K.Pr.Penale, urdhërohet heqja e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” caktuar me vendimin nr.117, datë 16.09.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
6. Në aplikim të neneve 30/1, 35, të Kodit Penal, dhënien e një dënimi plotësues, heqjen e së drejtës për të pandehurën Anila Dusha, për të ushtruar funksione publike, për 5 (pesë) vjet.

7. Në bazë të nenit 224 të K.Pr.Penale, CD me stampimin “Omega compact disc recordable CD-R 700 MB 52x”, sipas “Procesverbalit të datës 10.09.2024”; CD, sipas “Procesverbalit të kqyrjes së datës 11.09.2024”; CD, e marrë me “Procesvebalin e datës 11.09.2024”, nga studio e Top Chanel; 3 DVD, të marra sipas “Procesvebalit të datës 19.09.2024”, në Prokurorinë Elbasan; CD, e marrë me shkresën Nr.3260/1 Prot, datë 01.10.2024, nga Shoqëria “One Albania ShA”, mbeten pjesë e fashikullit gjyqësor.
8. Bazuar në nenin 393 të Kodit të Procedurës Penale, shpenzimet e kryera në fazën e hetimit paraprak, në shumën ***** lekë dhe shpenzimet gjyqësore, sipas formularit bashkangjitur i ngarkohen të pandehurës.
9. Kundër vendimit lejohet ankim nga palët në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 10.12.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar